



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

Mbi përqendrimin nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Investndërtim Tirana Sh.p.k nga shoqëria Investment Joti- Infosoft Group Sh.p.k

Në datën 19 Shkurt 2013, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Akt shitblerje kuotash”, të nënshkruar ndërmjet palëve (“Joti- Infosoft Group Sh.p.k” në cilësinë e blerësit dhe “GPL Costruzioni Generali S.r.l” në cilësinë e shitësit) më datë 21 Janar 2013, me objekt përfitimin e kontrollit të shoqërisë Investndërtim Tirana Sh.p.k nga shoqëria Investment Joti- Infosoft Group Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse në përqendrim është si vijon:

- **Investndërtim Tirana Sh.p.k:** ka si objekt veprimtaritë në shitjen, blerjen, administrimin, dhënie me qira, rikostruksionin e ndërtesave, hoteleve, qëndrave rezidenciale, tregtare, administrative dhe turistike si dhe kryerjen e shërbimeve të ndryshme në to si p.sh shërbime tregtare, reklamave, të argëtimit , etj.;
- **GPL Costruzioni Generali S.r.l:** është titullare e 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë Investndërtim Tirana Sh.p.k;
- **Investment Joti Sh.p.k:** ka si objekt veprimtaritë në blerja, shitja dhe mbajtja në pronësi të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, konsulenca në menaxhim dhe administrimin e biznesit, burimeve njerëzore etj.;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al